



Pranuar / Dorezuar Prinijeno/Prudato Received/Delivery	06.07.2023	viti god year	
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEKRETARAT	5082/2023		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.771/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-Kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë me Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.771/2023 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë:

kundër Vërejtjes me numër protokoli 116/04-8093 të datës 20.04.2023, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.771/2023 e datës 24.05.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore „Vërejtje” me numër protokoli 116/04-8093 e datës 20.04.2023 e shqiptuar ndaj ankueses nga Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112/01-4070 të datës 18.02.2022 në pozitën e punës “Zyrtare e Lartë për Gjendje Civile” në Drejtorin për Punë të Përgjithshme Administrative, Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës më datë 20.04.2023 ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje” me numër protokoli 116/04-8093 me arsyetimin për mos respektim të orarit të punës .

Ankuesja e pakënaqur me “Vërejtjen” e shqiptuar nga Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile, më datë 24.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4396/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile nuk është kompetente për të vendosur lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj saj, si dhe për sa i përket mos respektimit të orarit të punës e njëjta pretendon se për çdo mungesë nga puna ka kërkuar leje nga Drejtori i Administratës së Përgjithshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.06.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses. Ndërsa Këshilli me po të njëjtën datë ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokollit 4396/2023 e datës 24.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje me numër protokollit 116/04-8093 e datës 20.04.2023; Aprovimi i kërkesës së pushimit mjekësor i datës 17.01.2022-28.01.2022; Raport për prezencën në punë (hyrje në punë) periudha 01.01.2022 deri 24.04.2023; Raport për prezencën në punë (dalje nga puna) periudha 01.01.2022 deri 24.04.2023; Akt Emërim me numër AE.Nr.01-112/01-4070 i datës 18.02.2022; E-mail i datës 01.07.2022; E-mail i datës 02.12.2022; Raport mjekësor i datës 05.12.2022; Ankesë me numër 02-070/01-26879 e datës 24.11.2022; Deklaratë e datës 24.11.2022; E-mail i datës 19.04.2023; E-mail i datës 18.04.2023; E-mail i datës 05.12.2022; Thirrje për dëshmitarë i datës 17.04.2023; Letërnjoftim; E-mail i datës 18.08.2022; Vendim me numër protokollit 01 nr.112/02-17309 i datës 02.07.2021; Raport për zgjatjen e paaftësisë së përkohshme pengesës për punë 11.10.2022; E-mail i datës 24.04.2023; E-mail i datës 07.04.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 13.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.05.2023; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 01.02.2022; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2023; E-mail i datës 13.06.2023; Fletëdorëzim për refuzimin e Vërejtjes më datë 20.04.2023; E-mail i datës 22.09.2022; E-mail i datës 21.09.2022; E-mail i datës 20.04.2023; E-mail i datës 18.01.2023; E-mail i datës 07.03.2022; E-mail i datës 20.04.2022; E-mail i datës; E-mail i datës 16.08.2022; E-mail i datës 25.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila thekson se masa disiplinore "Vërejtje" me numër 116/04-8093 e datës 20.04.2023 është shqiptuar nga personi jo kompetent, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 47 paragrafit 1 pika 1.1 dhe nenit 48 të Ligjit Nr.06/L -114 për Zyrtar Publik ku përcaktohet se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", si dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) NR.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: "1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit", dhe mbi këtë bazë ka konstatuar se bazuar në Formularin e Përshkrimit të Detyrave të Punës së ankueses del se e njëjta për punën e saj raporton tek "Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile" në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë dhe si rrjedhojë për nga aspekti hierarkik edhe shqiptimi i masës disiplinore është bërë nga personi kompetent. Rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankueses se masa disiplinore "Vërejtje" është shqiptuar nga personi jo kompetent është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm ngase Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë masën disiplinore e ka shqiptuar në kuptim të dispozitave të lartcekura.

Më datë 20.04.2023 Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës, ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" me numër të protokollit 02-116/04/8093 ndaj ankueses për shkak të mos respektimit të orarit të punës konkretisht për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr.06/L -114 për Zyrtar Publik , Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Rregullores 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht për shkak të mungesës në punë dhe mosnjoftimit të mbikqyreses së drejtpërdrejtë më datat 18.01.2022, 07.03.2022, 20.04.2022, 01.07.2022, 16.08.2022 dhe 18.08.2022, respektivisht mos respektimit të njoftimeve verbale të Udhëheqëses së Drejtpërdrejtë si dhe njoftimit zyrtarë të datës 22.09.2022 përmes e-mailit për të gjithë zyrtarët e Sektorit të Gjendjes Civile.

Ndërlidhur me situatën faktike për mos respektimin e orarit të punës nga ana e ankueses mbi bazën e së cilës është shqiptuar "Vërejtja" ndaj ankueses Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe listën e vijueshmërisë të siguruar nga Komuna e Gjakovës për gjendjen aktuale të hyrje-daljeve në punë nga ana e ankueses dhe ka konstatuar se më datat 18.01.2022, 07.03.2022, 20.04.2022 dhe 01.07.2022 në sistemin e vijueshmërisë nuk figuron hyrja dhe as dalja rrjedhimisht ankuesja nuk është paraqitur fare në punë ndërsa më datën 16.08.2022 në kohën lokale (15:59) - dalje nga puna dhe 18.08.2022 në kohë lokale (16:00) - dalje nga puna, ndërsa nuk figuron hyrja, andaj me këtë rast Kolegji konstaton se ankuesja me veprimet e saj ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten"*, dhe Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë respektivisht nenin 9 paragrafi 1, 2, 3 dhe 5, ku përcaktohet se: *"1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mos regjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore"*, e në rastin konkret ankuesja pa ndonjë arsyetim nuk ka respektuar orarin e saj të punës dhe si rrjedhojë me veprimet e saj ankuesja ka bërë shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-1114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"*.

Tutje, Kolegji i Këshillit nga shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar për sa i përket datave 05.12.2022, 18.04.2023 dhe 19.04.2023 ankuesja për mungesë nga puna bazuar në datat e lartë cekura e ka njoftuar vetëm Drejtorin e Administratës së Përgjithshme mirëpo nuk e ka njoftuar dhe nuk ka marrë leje nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e saj respektivisht nga Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 9 paragrafin 4, 5, dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet saktësisht se: *"4.Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore"* si dhe *6.Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankueses, ka konstatuar se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në cilësinë e



Mbikëqyrëses së Drejtpërdrejtë, ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike dhe juridike në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" me numër protokoll 02-116/04-8093 të datës 20.04.2023 dhe ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili thekson se: „Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: "Ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit" si dhe në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1, 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke e arsyetuar vendimin në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe 2. Andaj për sa i përket pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji konstaton se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuar dhe të paqëndrueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.771/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Udhëheqëses së Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.